



# Rubeola

Rubeola (ose fruthi gjerman) është një sëmundje infektive që shkakton puçrra me pika. Normalisht nuk është diçka serioze, por është shumë e rrezikshme për një grua shtatzënë dhe për fëmijën e saj. Që nga shpikja e vaksinës MMR, tani rubeola është diçka e rrallë në Mbretërinë e Bashkuar.

## Infektimi me rubeolë

Rubeola përhapet nga kolla dhe teshtimat.

Një person që ka rubeolë mund ta përhapë infeksionin duke filluar nga 1 javë para se të shfaqen simptomat deri në 5 ditë pasi shfaqen puçrrat.

Është shumë e rëndësishme që një person me rubeolë të shmangë kontaktin nga afër me këdo që është shtatzënë.

## Simptomat e rubeolës



skuqje e lëkurës me puçrra



temperaturë



dhimbje, skuqje e syve



dhimbje koke



dhimbje në kyçe te gratë e mëdha në moshë

Simptomat kryesore të rubeolës janë puçrrat me pika që fillojnë të shfaqen në fytyrë ose mbrapa veshëve dhe përhapen në qafë dhe në trup. Puçrrat shfaqen 2 deri në 3 javë pas infektimit me rubeolë. Disa simptoma të tjera mund të jenë kollë, rrjedhje hundësh dhe dhimbje fyti. Zakonisht rubeola është diçka e lehtë dhe disa njerëz nuk kanë asnjë simptomë.

## Komplikacionet e mundshme

Nëse infektoheni me rubeolë që në fillim të shtatzënisë, mund të dështoni, fëmija mund të lindë pa jetë ose mund të ketë probleme me rritjen dhe zhvillimin e fëmijës në bark. Kjo mund të shkaktojë probleme për fëmijën, si për shembull aftësi të kufizuara mësimore, mungesë të shikimit, mungesë të dëgjimit, probleme me rritjen dhe probleme me zemrën. Nuk ekziston asnjë trajtim ose kurë për rubeolën.



Telefononi maminë, maternitetin ose klinikën e mjekut tuaj nëse jeni shtatzënë dhe nëse:

- ju shfaqet skuqje e lëkurës me puçrra
- keni pasur kontakt nga afër me dikë që ka rubeolë

## Rubeola në shifra


Nëse infektoheni me rubeolë që herët gjatë shtatzënisë, ekziston rreziku 1 në 5 që të dështoni fëmijën.



9 nga 10 fëmijë që i mbijetojnë infeksionit të rubeolës herët në shtatzëni do të lindin me aftësi të kufizuara të përrjetshme.



7 në 10 gra të infektuara me rubeolë kanë dhimbje kyçesh.



## Parandalimi i rubeolës

Vaksina MMR është mënyra më e mirë për të parandaluar rubeolën.

Të gjithë kanë nevojë për dy doza; më e mira është të bëhen në moshën 1 vjeç, dhe në moshën 3 vjeç e 4 muaj. Vaksina MMR të mbron gjithashtu nga fruthi dhe nga shytat.

Vaksina MMR punon shumë mirë. Pas 2 dozash, 99% e njerëzve do të jenë të mbrojtur nga rubeola.

Vaksina është falas për këdo. Nëse ju ose fëmija juaj nuk e kryen një dozë, kontaktoni klinikën e mjekut të përgjithshëm. Asnjëherë nuk është tepër vonë për ta bërë vaksinën.

**Doza e parë  
mosha 1 vjeç**



**Doza e dytë 2  
mosha 3 vjeç e  
4 muaj**



**Më shumë rreth rubeolës**



(nhs.uk)

**Sindroma e rubeolës së  
lindur: Historia e lanit**



(YouTube.com)

**Më shumë rreth vaksinës MMR**



(nhs.uk)

Ky nuk është një mjet për diagnostikim. Nëse mendoni se fëmija juaj mund të ketë rubeolë, telefononi klinikën e mjekut të përgjithshëm ose 111 menjëherë.

Zhvilluar nga NHS North Central London Integrated Care Board.